



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2021:054487  
Datë: 20.06.2024  
Numri i dokumentit: 05839853

**C.nr.473/2021**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil,** gjyqtari Taulant Rexhëbeqaj, në çështjen juridiko kontestimore të paditësit J.H., me numër personal ..... nga Fushë Kosova, të cilin me autorizim e përfaqëson “Avokatura Istrafi”, SH.P.K, me seli në Prishtinë, kundër të paditurës B.K.S. me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Kompania e Sigurimeve “P.....”, me seli në Prishtinë, e të cilën me autorizim e përfaqëson L.S. për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit 41,504.32 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor - publik, me datë 20.05.2024 në të cilën prezantuan të autorizuarit e ndërgjyqësve mori, ndërsa më datë 20.06.2024, përpiloi me shkrim, këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I. APROVOHET PJESËRISHT e bazuar** kërkesëpadia e paditësit J.H. nga Fushë Kosova dhe **DETYROHET** e paditura B.K.S. me seli në Prishtinë, që në emër të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial, të shkaktuar në aksidentin e datës 11.10.2020, ti paguaj paditësit J.H. shumat si në vijim, dhe atë:

*1) Dëmi jo material:*

- a) për dhimbje fizike (trupore), shumën prej..... **5,000.00 €**
- b) për frikë, shumën prej .....**5,000.00 €**
- c) për zvogëlim të aktivitetit jetësor në shkallën prej 18.40%, shumën prej.....**11,000.00 €**
- d) për shëmtim, shumën prej.....**4,000.00 €**

Shuma të cilën është e detyruar e paditura, që t’ia paguaj paditësit, në emër të dëmit jo material të shkaktuar tek paditësi, është **shuma e përgjithshme prej 25,000.00 € (njëzetë e pesë mijë)**, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e marrjes së aktgjykimit (20.05.2024) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

*2) Dëmi material:*

- e) në emër të ndihmës së personit të tretë, shumën prej.....**250.00 €**
- f) në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej.....**490.00 €**
- g) në emër të shpenzimeve të mjekimit, shumën prej ..... **1,274.00 €**
- h) në emër të fitimit të humbur, nga data 11.10.2020-30.11.2023, shumën prej.....**3,090.32 €**

i) në emër të fitimit të humbur prej datës 01.12.2023 në formë rentës mujore shumë prej **37.44 € (tridhjetë e shtatë euro e dyzetë e katër centë)**, për çdo muaj më së largu deri më datën (5) të muajit, për muajin paraprak dhe atë derisa të ekzistojnë kushtet ligjore. Shuma e përgjithshme në emër të dëmit material është në lartësi prej **5,104.32 € (pesëmijë e njëqind e katër euro, e tridhjetë e dy cent)**, pa u llogaritur renta mujore, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë në gjykatë (23.03.2021) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

**II.** Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit J.H. përtej shumës së aprovuar si në pikën I, nën 1), të këtij aktgjykimi dhe atë: për a) për dhimbje fizike (trupore) shuma prej 1,500.00 €; b) për frikë shuma prej 500.00 €; c) për zvogëlim të aktivitetit jetësor në shkallën prej 18.40 % shuma prej 7,400.00 €; dhe d) për shëmtim shuma prej 2,000.00 €, **refuzohet si e pabazuar.**

**III. OBLIGOHET** e paditura, që në emër të shpenzimeve procedurale t'i paguajë paditësit, shumë prej **1,989.60 € (njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë euro, e gjashtëdhjetë cent)**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit të dhunshëm.

## **A r s y e t i m**

Paditësi J.H. nga Fushë Kosova, të cilin me autorizim e përfaqëson "Avokatura Istrafi", SH.P.K, me seli në Prishtinë, me datën 23.03.2021, pranë kësaj gjykate, ka parashtruar padi, të cilën e ka precizuar në shqyrtimin e datës 05.04.2024, ndaj të paditurës B.K.S. me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Kompania e Sigurimeve "P.....", me seli në Prishtinë, për shkak të kompensimit të dëmit, vlera e kontestit 41,504.32 €.

### *1. Pretendimet e palëve ndërgjyqëse*

Në padinë e paraqitur, të autorizuarit e paditësit kanë theksuar se me datën 11.10.2020, rreth orës 16:32, në Landovicë, komuna e Prizrenit, është shkaktuar fatkeqësia e komunikacionit, në të cilën lëndime të rënda trupore pësoi paditësi J.H. Fatkeqësia është shkaktuar kur ngasësi i automjetit bujqësor – traktor Ferguson IMT 539 pa targa- A.Sh. i cili qarkullonte në rrugën lokale të fshatit .... me të arritur tek varrezat e dëshmorëve në fshatin ..... në mënyrë të pasigurt kyçet në rrugën rajonale në drejtimin e Prizrenit, në mënyrë të pasigurt ndërmerr veprim kyçje për në rrugën kryesore Gjakovë-Prizren, duke mos i dhënë përparësi automjeteve në rrugë me përparësi kalimi, me ç rast ndeshet me motoçikletën Suzuki me targa .... të cilën e ngiste këtu paditësi. Si pasojë e kësaj goditje, lëndime të rënda trupore pëson ngasësi motoçikletës J.H.

I autorizuari i paditësit edhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore, ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, ndërsa në shqyrtimin e datës 05.04.2024, e ka bërë precizimin e kërkesëpadisë. Në fjalën përfundimtare, i autorizuari i paditësit ka deklaruar se me provat e administruara është vërtetuar baza juridike e kërkesëpadisë e cila nuk ishte kontestuese as nga e paditura, ndërsa sa i përket lartësisë së saj, gjykatës i ka propozuar që kërkesëpadinë e precizuar me parashtrësën e datës 05.04.2024, ta aprovoje në tërësi si të bazuar, në të cilën

parashtresë janë dhënë edhe arsytet se shumatat e kërkuara janë në përputhje me pasojat e përhershme të lëndimeve të pësuar. Sa i përket fitimit të humbur ka theksuar se kjo është kërkesë e bazuar edhe në nenin 173 par.3 i LMD-së dhe e njëjta nuk është e varur nga dëmi jo material që është zvogëlimi i aktivitetit jetësor, pasi paditësi me prova materiale e ka vërtetuar se bazuar në pa aftësinë e punës në shkallë prej 24% në të ardhmen, e mbështetur edhe në ekspertizën financiare ka pësuar dhe vazhdon të pësojë humbje të ardhurave për këtë shkallë të pa aftësisë, bazuar edhe në shkollimin e tij universitar. Andaj mbështetur në dispozitat e LMD-së, neni 136, 169, par. 3 dhe 4, neni 172, 173, dhe dispozitat e LSDA-së neni 3, 9, 18, 32, kërkesëpadsisë e paditësit ta aprovoje në tërësi si të bazuar, së bashku me kamatën.

Shpenzimet e procedurës kontestimore i ka kërkuar në shumë të përgjithshme prej 2,197.60 €, të specifikuar në fjalën përfundimtare dhe në parashtresën e datës 05.04.2024.

E paditura përmes përgjigjes në padi të datës 16.02.2022, ka theksuar se konteston kërkesëpadinë e paditësit për nga lartësia e saj, duke shtuar se e paditura nuk ka arritur që të vlerësoj shkallën e lëndimeve dhe kohëzgjatjen e tyre të shkaktuar tek paditësi si pasojë e aksidentit të lartcekur. Tutje ka shtuar, se në këtë fazë të procedurës e fton palën paditëse për ekzaminim, pranë zyrës së të paditurës, në të kundërtën gjykatës i ka propozuar që padinë e paditësit ta hedhë poshtë si të palejuar.

Edhe gjatë shqyrtimeve gjyqësore i autorizuari e të paditurës ka mbetur në tërësi sikurse në përgjigjen në padi. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi dhe deklarimeve të dhëna përgjatë shqyrtimit gjyqësor, duke ritheksuar faktin se e paditura nuk e konteston bazën juridike të kërkesëpadsisë, mirëpo kontestuese është lartësia e kërkesëpadsisë e kërkuar me anë të precizimit të lartësisë së saj dhe atë për dhembje fizike, frike, shëmtim dhe zvogëlim të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, e në veçanti për kategorinë e dëmit jo material-shëmtinë trupor, sepse për këtë kategori në bazë të udhëzuesit të Gjykatës Supreme, theksohet se maksimumi për këtë kategori të dëmit parashihet shuma në vlerë prej 3000 euro, e po ashtu edhe për kërkesën në emër të ZAJ-së meqenëse në rastin konkret kemi të bëjmë në shkallë prej 18,40%, maksimumi sipas këtij udhëzuesi edhe hipotetikusht të ishte 20%, parashihet vlera prej 11,000 euro. Po ashtu, e paditura e konteston edhe lartësinë e dëmit material për ushqim të përforcuar, ngase konsideron se është jashtëzakonisht e lartë dhe jo në proporcion me praktikën gjyqësore. E paditura e kundërshton në tërësi kërkesën në emër të fitimit të humbur në forme të rentës, pasi që ka konsideruar se nuk janë plotësuar kushtet që paditësit të i takojë kjo e drejtë, meqenëse aksidenti ka ndodhur me datë 11.10.2020 dhe i njëjti në baze të provave dhe atë pasqyrës së llogarisë nga trusti shihet se ka zhvilluar punë të vazhdueshme e për më tepër me të njëjtën pagë, andaj në rastin konkret nuk mund të zbatohet dispozita nga neni 173 par.3 i LMD-së, meqenëse për të njëjtin nuk ka një lloj humbje në aspektin financiar, dhe kjo është vërtetuar edhe me plotësimin e ekspertizës së akuaristikës në faqen 2 të saj. Po ashtu, e ka kundërshtuar edhe kërkesën që kamata vjetore prej 8% të rrjedhë nga data e ushtrimit të padisë sepse konsideron se afati fillon të rrjedhë nga momenti i marrjes së aktgjykimit, ashtu siç parashihet në mendimin juridik të Gjykatës Supreme. Sa i përket kërkesës lidhur me shpenzimet gjyqësore gjykatës i ka propozuar që me rastin e vendosjes të merr parasysh suksesin e paditësit në realizimin e kërkesëpadsisë, por specifikisht i ka kundërshtuar shpenzimet në emër të përpilimit të

parashtresës për precizim të lartësisë së padisë sepse një kërkesë e tillë është konsumuar me rastin e kërkesës për njohjen e shpenzimeve në emër të përpilimit të padisë, po ashtu i ka kundërshtuar edhe shpenzimet e ekspertizës mjekësore për vlerësimin e pa paaftësisë së punës dhe atë akuaristikës si të panevojshme meqenëse nxjerrja e tyre ka qenë jo relevante në këtë procedurë gjyqësore.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

## 2. Provat e administruara

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike kontestimore gjykata ka bërë administrimin e këtyre provave: ekspertizën mjekësore (për vlerësimin e aftësisë punuese), të punuar nga eksperti Prof. Dr. Xh.Sh. e datës 13.09.2023, si dhe dëgjimin e ekspertit në shqyrtimin e datës 10.10.2023; Ekspertizën e ortopedisë - traumatologjisë dhe ekspertizën e psikiatrisë të punuar nga Dr. M.H. dhe Dr. N.I.M. e datës 26.07.2023; raportin e aksidentit me numër 2020-GR-0552, të datës 11.10.2020; raportin mjekësor me numër rendor 55456, të datës 11.10.2020, të lëshuar nga SHSKUK; fletë lëshimi me numër të historisë 1514, të datës 27.10.2020, të lëshuar nga QKUK; kontratën e punës për punë dhe detyra specifike të datës 01.01.2021; raportin e trustit për periudhën 11.07.2008, deri më 03.03.2023, në emër të paditësit; diplomën e lëshuar nga Kolegji Tempulli, për paditësin; gjendjen e llogaris së Trustit, për paditësin për periudhën 11.07.2008, deri më datë 01.12.2023; vërtetimin e lëshuar nga Departamenti i Pensioneve, në Prishtinë me nr. 05/4747/23, të datës 12.12.2023; ekspertizën e aktuaristikës, të datës 30.11.2023, të punuar nga ekspertja G.Sh. si dhe deklarin e ekspertes në shqyrtimin e datës 11.01.2024; plotësimin e ekspertizës aktuaristike-financiare, të datës 01.03.2024, të punuar nga ekspertja G.Sh. kontratën e punës, për punë dhe detyra specifike e lidhur në mes të grupit Koha-punëdhënës dhe paditësit-punëmarrës e datës 01.01.2024; fatura dhe kuponët fiskal të specifikuar në parashtresën e datës 06.12.2023, të titulluar “specifikacion i shpenzimeve materiale për J.H.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të theksuara më lartë në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), duke i çmuar me kujdes dhe me ndërgjegje çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit **është pjesërisht e bazuar**.

Nga leximi i ekspertizës mjekësore (për vlerësimin e aftësisë punuese), të punuar nga eksperti Prof. Dr. Xh.Sh. e datës 13.09.2023, gjykata vërtetoi faktin se paditësi J.H. në aksidentin e datës 11.10.2020, kishte pësuar lëndime të cilat kualifikohen në grupin e lëndimeve të rënda trupore, të cilat për pasojë kanë vështirësimin dhe zvogëlimin e mundësisë së kryerjes së disa profileve të punës dhe aktivitete punuese, si dhe zvogëlim të aftësisë së përgjithshme të punës. Me pasojat e pësuar nga lëndimet në aksident, paditësi ka vështirësi dhe kufizim në ushtrimin e profesioneve ku kërkohet që gjatë ekzekutimit të tyre të qëndron kohë të gjatë në pozitë vertikale/në këmbë, përqendrim në këmbën e majtë, të zhvillojë punë që kërkojnë ecje të shpeshta nëpër shkallë, puna në pozitë përulur, punë precize me këmbën majtë dhe puna ku kërkohet ngritja, mbartja dhe bartja e peshave të rënda me dorën e majtë, puna në punë precize me dorën e majtë dhe puna në lartësi për shkak të pasigurisë edhe nga këmba e

edhe nga dora e majtë. Eksperti pas vlerësimit të aftësisë së punës së paditësit, me ekzaminimin e drejtpërdrejtë, shqyrtimit të dokumentacioneve mjekësore dhe mendimeve dhe konstatimeve të ekspertëve të lëmive përkatëse ka konstatuar se zvogëlimi i aftësisë së përgjithshme të punës i përhershëm tek paditësi J.H. është 25 %. Paaftësia e përkohshme për punë nga lëndimi është shprehur tek paditësi, për vitin e parë pas lëndimit nga data 11.10.2020, e deri me 10.10.2021, në shkallë prej 99%, për kurrfarë pune as fizike e as psiqike, për shkak të lëndimeve të pësuar, hospitalizimit, intervenimeve, kufizimit të lëvizjeve, kontrolleve të shpeshta dhe ekzaminimeve përcjellëse. Për 12 muajt vijues, prej datës 11.10.2021, e deri me 10.10.2022, paaftësia për punë është shprehur në 50 %, ndërsa nga data 11.10.2022, e më tutje Zvogëlimi i aftësisë së përgjithshme të punës është i përhershëm në shkallë prej 24%.

Gjykata në shqyrtimin e datës 10.10.2023, ka bërë dëgjimin e ekspertit Xh.Sh. specialist i mjekësisë së punës, i cili ka deklaruar se vlerësimi është bërë për zvogëlimin e përgjithshme të aftësisë së punës dhe në ekspertizë janë sqaruar profilet e punëve në të cilat paditësit nuk do të mund të angazhohej për shkak të pasojave të pësuar në këtë aksident. Invaliditeti tek rasti konkret sipas kategorizimit bie në invaliditetin e shkallës së parë që d.m.th. rehabilitimi profesional. Është e rëndësishme që të potencohet se nuk ka ndarje strikte në kategorizimin e punëve “intelektuale” nga ato “fizike” sepse nga aspekti ditaktik kështu qëndron por në praktikë nuk ka punë “intelektuale” e cila do të mund të kryhej pa përfshirjen e punëve “fizike” dhe e kundërta. Tutje ka shtuar se ku bëhet fjalë për punën “fizike” dhe “intelektuale”, pavarësisht prej këtyre kategorive te paditësi ka invaliditet prej 25%, i cili reflektohet në efikasitet në kryerjen e punëve dhe obligimeve edhe tek kualifikimi të cilin e posedon. Sa i përket profilit të cilat nuk mund të kryej apo për të cilat ka vështirësi në kryerjen e tyre, punë të cilat i kërkojnë mbajtje, bartje, që kanë lidhshmëri me lëvizshmërinë e gjurit (si segmenti më i tanguar në aksident) punët të cilat kërkojnë vrapim (meqenëse me pasojat të cilat janë të pranishme si artroza e gjurit e lidhur kauzalisht me pasojat nga lëndimi, kufizimi i shkallës së rëndë të lëvizjeve të gjurit, shkurtimi i këmbës, çalimi), janë pasoja që vështirësojnë punën ku kërkohet precizitet i ekzekutimit të punëve që kryhen në pozitë vertikale. Veçanërisht vështirësitë manifestohen me ecjen – lëvizjen nëpër shkallë dhe atë në dy drejtime, si dhe puna në të cilën kërkohet që të ekzekutohet në lartësi për shkak të sigurisë në përqendrimin e këmbës së majtë dhe të dorës së majtë. Përfundimisht lëndimet e pësuar nga këtu paditësi paraqesin vështirësi në kryerjen e të gjitha llojeve të punës.

Nga leximi i ekspertizës së ortopedisë - traumatologjisë dhe ekspertizën e psikiatrisë të punuar nga Dr. M.H. dhe Dr. N.I.M. e datës 26.07.2023, lidhur me ekzaminimin e paditësit J.H. gjykata ka vërtetuar se paditësi, në aksidentin e datës 11.10.2020, ka pësuar lëndime trupore dhe frikë. Nga ekzaminimi i drejtpërdrejtë i paditësit, si dhe dokumentacioni në shkresat e lëndës, ekspertët kanë konstatuar se dëmtimet e paditësit paraqesin thyerje të hapur shumëpjesëshe të kofshës së majtë me defekt të madhe të kockës. Thyerje të pjesës së poshtme rrezorit të majtë, të shkaktuar nga goditja në pjesë të fortë si pasojë e aksidentit dhe si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të rënda trupore. I njëjti ka qëndruar në Klinikën e Ortopedisë ku është operuar në kofshën e majtë dhe është bërë reponimi ortopedik i dorës së majtë, ka mbajtur imobilizim me gips. Në momentin e dëmtimit dhe gjatë trajtimit mjekësor, të cilat paditësit në fjalë i kanë shkaktuar: dhimbje fizike: - me intensitet posaçërisht të rëndë – 60 minuta, koha e kaluar nga aksidenti e deri te transporti, shtrirja e pjesëve të lënduar, etj., deri në mjekim dhe

marrjen e terapisë kundër dhimbjes- të intensitetit të lartë – 5 ditë, kohë pas kohe, deri në marrjen e terapisë adekuate, duke pas parasysh thyrjen e kofshës së majtë dhe rrezorit të majtë, - të intensitetit të mesëm- 70 ditë, kohë pas kohe deri në marrjen e terapisë adekuate dhe - të intensitetit të ulët- ka edhe sot e kësaj dite, posaçërisht gjatë sforcimeve fizike dhe ndryshimeve klimatike. Shëmtim trupor – ka në shkallë të mesme- për shkak të vrrajës jo të rregullt, si pasojë e plagës operatorë në kofshën e majtë me gjatësi 40 cm dhe gjerësi 1 cm, e dukshme kohë pas kohe, e sidomos në periudhat e ngrohta të motit. Zvogëlimi i aktivitetit të përgjithshëm jetësor është 18.40 %, që është si pasojë e artrozës postraumatike me kufizimin e lëvizjes në shkallë të mesme të nyjës së gjurit të këmbës së majtë dhe kufizimit të lëvizjes në nyjën e byzylykut të dorës së majtë në shkallë të lehtë. Ndihma dhe kujdesi i personit të huaj – ka qenë e nevojshme për 70 ditë, që nënkupton ndihmë mjekësore profesionale dhe ndihmë joprofesionale nga personat tjerë. Ushqim i përforcuar- ka qenë i nevojshëm deri në 70 ditë, ushqim i pasur me proteina, minerale, vitamina, karbohidrate të nevojshme për ngjitjen dhe sanimin e lëndimit, si dhe reaksionit post traumatik. Rehabilitimi fiziatrik ka qenë i nevojshëm 35 ditë, i nevojshëm për përmirësimin e lëvizjes në nyjë të gjurit të këmbës së majtë, në nyjën e byzylykut të dorës së majtë, si dhe rritjen e forcës dhe masës muskulore të dobësuar. Në aksidentin e datës 11.10.2020, paditësi J.H. ka përjetuar frikë primare, e cila ka zgjatur disa sekonda, në formë të frikës nga vdekja dhe kërcënimit të drejtpërdrejtë të integritetit të tij fizikë, frikë sekondare të intensitetit të lartë e cila ka zgjatur 5 ditë, e manifestuar me gjendje të reagimit akut ndaj stresit të përjetuar, anktheve, pagjumësisë, rikujtimeve të ngjarjes traumatike, me frikë të invaliditetit të përhershëm, frikë sekondare të intensitetit të mesëm-2 muaj, e manifestuar me gjendje të ankthit e stresit, pagjumësisë, vështirësive të adaptimit me kushtet e imobilizimit mjekësor dhe frikë sekondare të intensitetit të ulët, e cila është prezentë edhe sot e kësaj dite, e manifestuar me ankthe të herëpashershme, rikujtime të ngjarjes traumatike, shqetësime emocionale, indisponim, mungesë të vetëbesimit, si dhe pasigurisë, sidomos gjatë përfshirjes në komunikacion, e cila ka ndikuar në dëmtim të dinamikës së personalitetit, duke e bërë më të brishtë dhe vulnerabil në jetën e përditshme, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor.

Nga leximi i raportit të aksidentit me numër 2020-GR-0552, të datës 11.10.2020, gjykata ka vërtetuar se: me datën 11.10.2020, rreth orës 16:32 minuta, në Landovicë kishte ndodhur aksidenti i komunikacionit. Deri tek aksidenti kishte ardhur kur vozitësi me traktor Ferguson ngjyrë të kuqe, pa targa, ishte duke lëvizur në rrugën lokale të fshatit Tupec, me të arritur tek varrezat e dëshmorëve në fshatin Landovicë, merr veprim në mënyrë të pasigurt kyçet në rrugën rajonale në drejtimin e Prizrenit, duke mos i dhënë përparësi automjeteve në rrugë me përparësi kalimi, me ç rast ndeshet me motoçikletën Suzuki me targa..... dhe n pamundësi që të ndalet e godet me pjesën e parme të motoçikletës në pjesën e pasme të traktorit. Si pasojë e kësaj goditje, lëndime të rënda trupore pëson ngasësi motoçikletës J.H. i cili pas marrjes së ndihmës mjekësore në emergjencën e Spitalit Rajonal në Prizren, dërgohet në QKUK-Prishtinë, në tretman të mëtutjeshëm mjekësor.

Nga leximi i raportit mjekësor me numër rendor 55456, të datës 11.10.2020, të lëshuar nga SHSKUK, gjykata vërtetoi faktin se paditësi ishte dërguar nga Emergjencia e Prizrenit, në Klinikën Emergjente në Prishtinë, me datë 11.10.2020.

Nga leximi i fletë lëshimit me numër të historisë 1514, të datës 27.10.2020, të lëshuar nga QKUK, gjykata vërtetoi faktin se paditësi J.H. ishte mjekuar nga data 12.10.2020, deri me datë 27.10.2020, në QKUK në Prishtinë, për shkak të lëndimit, si pasojë e aksidentit të komunikacionit.

Nga leximi i kontratës së punës për punë dhe detyra specifike të datës 01.01.2021, gjykata vërtetoi faktin se paditësi J.H. kishte lidhur kontratën e punës me punëdhënësin “...” SH.P.K, me seli në Prishtinë, për kryerjen e detyrave në vendin e punës mirëmbajtje teknike. Kontrata është lidhur për kohë të caktuar nga data 01.01.2021, deri me datë 31.12.2021.

Nga leximi i raportit të trustit për periudhën 11.07.2008, deri më 03.03.2023, në emër të paditësit, gjykata konstatoi se në të njëjtin janë të paraqitur gjenerimi i të ardhurave personale të paditësit Jeton Haliti.

Nga leximi i diplomës të lëshuar nga Kolegji Tempulli, në emër të paditësit J.H. gjykata vërtetoi faktin se i njëjti kishte kryer Studimet Themelore Universitare në Postë dhe Telekomunikacion.

Nga leximi i gjendjes së llogaris së Trustit, për paditësin për periudhën 11.07.2008, deri më datë 01.12.2023, gjykata konstatoi se në të njëjtin janë të paraqitur gjenerimi i të ardhurave personale të paditësit Jeton Haliti.

Nga leximi i vërtetimit të lëshuar nga Departamenti i Pensioneve, në Prishtinë me numër 05/4747/23, të datës 12.12.2023, gjykata vërtetoi faktin se paditësi J.H. me vendbanim në Fushë Kosovë, nuk është përfitues i Pensionit për Personat me Aftësi të Kufizuara.

Nga leximi i ekspertizës së aktuaristikës, të datës 30.11.2023, të punuar nga ekspertja Gresa Shabani, gjykata ka vërtetuar se si bazë për llogaritjen e fitimit të humbur dhe rentës për të ardhmen janë marrë parasysh të ardhurat mesatare nga Agjencioni i Statistikave i Kosovës, sipas nivelit të pagave mesatare të ndara për sektorët ekonomik, konkretisht për sektorin e informimit dhe komunikimit, ku hyn dhe kategoria e kualifikimit të paditësit, e të cilat për periudhën kontestuese arrijnë nivelin prej 697.00 euro për vitin 2020, 757.00 euro për vitin 2021 dhe 896.00 euro për vitin 2022, vlera të cilat janë llogaritur në propocion me shkallën e zvogëlimit të aftësisë punuese të paditësit. Ekspertja ka konstatuar se shuma e cila duhet ti paguhet paditësit, në emër të fitimit të humbur nga data e aksidentit 11.10.2020, deri me datën 31.11.2023, arrin vlerën prej 13,163.88 euro, ndërsa renta mujore e cila duhet ti paguhet paditësit nga data 01.12.2023, llogaritur mbi bazën prej 896.00 euro dhe për nivelin e paaftësisë punuese prej 24 %, arrin totalin mujor në lartësi prej 215.04 euro. Po ashtu, ekspertja ka konstatuar se renta mujore mund të jepet edhe si vlerë e menjëhershme apo e kapitalizuar, e cila e arrin vlerën prej 40,162.00 euro.

Gjykata në shqyrtimin e datës 11.01.2024, ka bërë dëgjimin e ekspertes së aktuaristikës G. Sh. e cila ka deklaruar se duke marr parasysh provat të cilat janë administruar në këtë seancë e veçanërisht gjendja e pasqyrës së llogarisë nga Trusti, ekspertiza e datës 30.11.2023

duhet të plotësohen në kuptim të këtyre provave. Pas deklarimit të ekspertës, i autorizuari paditësit ka propozuar që të bëhet plotësimi i ekspertizës së datës 30.11.2023.

Nga leximi i plotësimi të ekspertizës aktuaristike-financiare, të datës 01.03.2024, të punuar nga ekspertja G.Sh. gjykata vërtetoi faktin se ekspertja e ka dhënë mendimin plotësues për llogaritjen e diferencës së të ardhurave të cilat i realizon paditësi, në raport me zvogëlimin e aftësisë punuese të tij, sipas mendimit të mjekëve ekspert nga lëmia e punës. Ekspertja ka konstatuar se shuma e cila duhet ti paguhet paditësit, në emër të fitimit të humbur nga data e aksidentit 11.10.2020, deri në ditën e hartimit të ekspertizës së parë me datën 31.11.2023, arrin vlerën prej 3,090.32 euro, ndërsa renta mujore e cila duhet ti paguhet paditësit nga data 01.12.2023, e tutje deri sa për të njëjtën të ekzistojnë kushtet ligjore arrin shumën mujore në lartësi prej 37.44 euro. Po ashtu, ekspertja ka konstatuar se renta mujore mund të jepet edhe si vlerë e menjëhershme apo e kapitalizuar, e cila e arrin vlerën prej 6,992.00 euro

Nga leximi i kontratës së punës, për pune dhe detyra specifike e lidhur në mes të grupit Koha-punëdhënës dhe paditësit-punëmarrës e datës 01.01.2024, gjykata vërtetoi faktin se paditësi J.H. kishte lidhur kontratën e punës me punëdhënësin “Grupi Koha” SH.P.K, me seli në Prishtinë, për kryerjen e detyrave në vendin e punës mirëmbajtje teknike. Kontrata është lidhur për kohë të caktuar nga data 01.01.2024, deri me datë 31.12.2024.

Nga leximi i faturës dhe kuponët fiskal të specifikuar në parashtresën e datës 06.12.2023, të titulluar “specifikacion i shpenzimeve materiale për J.H.”, gjykata ka konstatuar faktin se paditësi J.H. gjatë trajtimit mjekësor si pasojë e lëndimeve të marra gjatë aksidentit të përshkruar, ka arritur shpenzime në shumën e përgjithshme prej 1,274.80 euro.

### 3. Baza Ligjore

Neni 136 i Ligjit të Marrëdhënieve të Detyrimeve, par.1 të tij përcakton se: “Kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë ta kompensoj, në qoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij”, neni 137 i po këtij ligji përcakton: “Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material).”, neni 140 i këtij ligji përcakton: “Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia”, ndërsa neni 159 i po këtij ligji përcakton se: “Në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar për faj të një poseduesi të automjetit, vihen në zbatim rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë”. Sipas nenit 169, par.1, është përcaktuar se: “Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi.”, par.2. “Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të japë shpërblimin në të holla.” dhe par. 3. “Kur rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk është e mundur, apo kur gjykata konsideron se nuk është e domosdoshme që këtë ta bëjë personi përgjegjës, gjykata do të caktojë që ai t’ia paguajë të dëmtuarit shumën përkatëse në të holla në emër të shpërblimit të dëmit”. Neni 172 par.1, i ligjit të lartcekur ka përcaktuar se: “Në rast të vdekjes, të lëndimit trupor ose të dëmtimit të shëndetit, shpërblimi caktohet, sipas rregullës, në formë të rentës në të holla, për



*gjithë jetën ose për një kohë të caktuar”, ndërsa par. 2 i këtij neni përcakton se: “Renta në të holla e gjykuar në emër të shpërblimit të demit paguhet për çdo muaj përpara, në qoftë se gjykata nuk cakton diç tjetër”. Neni 174 i këtij ligji përcakton: “Gjykata duke marr parasysh edhe rrethanat që janë shkaktuar pas shkaktimit të demit, do të gjykojë shpërblimin në një shumë e cila është e nevojshme që gjendja materiale e të dëmtuarit të sillet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues”. Ndërsa neni 179 i këtij ligji përcakton: “Kush i shkakton tjetrit lëndim trupor ose ia dëmton shëndetin ka për detyrë të shpërblejë shpenzimet rreth mjekimit dhe shpenzimet tjera të nevojshme lidhur më këtë, si dhe fitimin e humbur për shkak të paaftësisë për punë gjatë kohës së mjekimit”, kurse neni 183 par.1 i po këtij ligji përcakton: “Për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore për shkak të zvogëlimit të aktivitetit jetësor,..., si dhe frikës etj., gjykata po të konstatoj se rrethanat e rastit e sidomos intensiteti i dhembjeve dhe i frikës dhe zgjatja e tyre e arsyetojnë këtë, do të gjykojë shpërblimin e drejtë në të holla, pavarësisht nga kompensimi i demit material...”, ndërsa par.2 i këtij ligji përcakton: “Me rastin e vendosjes për kërkesën e shpërblimit të demit jo material, si dhe për lartësinë e shpërblimit të tij, gjykata do të kujdeset për rëndësinë e cenimit të mirës si dhe qëllimit të cilit i shërben ky shpërblim, por edhe për atë, se me të mos të favorizohen synimet që nuk janë në pajtim me natyrën e saj dhe më qëllimin shoqëror”. Gjithashtu me nenin 323 i LPK-së përcaktohet se “Po që se vërtetohet se palës i takon e drejta që t’i shpërblehet dëmi me të holla apo me sende të zëvendësueshme, por pa mundësi që të caktohet shuma e të hollave, apo sasia e sendeve të tilla, apo se një gjë e tillë do të mund të bëhej me vështirësi shumë të mëdha, gjykata për këtë do të vendosë sipas çmuarjes së lirë”.*

Po ashtu bazuar në nenin 10 të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (Ligji Nr. 04/L-018), parasheh “Kompensimi i demit material dhe jomaterial bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit për marrëdhëniet e detyrimeve” dhe sipas nenit 11, par.1, është përcaktuar se: “Personi i dëmtuar të cilit i është shkaktuar dëmi brenda territorit të Republikës së Kosovës nga një mjet motorik, pronari i të cilit nuk është i mbuluar nga sigurimi i autopërgjegjësive, ka të drejtë të kërkojë dëmshpërblimin e demit nga Byroja”..

#### Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës

Pas analizimit dhe vlerësimit të provave të lartcekura gjykatës i rezultoi se mes palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese baza juridike e kërkesëpadisë andaj në këtë drejtim gjykata nuk e ka nxjerr prova të veçanta. Në rastin konkret, gjykata ka konstatuar se ekziston lidhja shkakësore juridike në mes aksidentit të ndodhur dhe lëndimeve të paditësit të cilin fakt gjykata e vërtetoi nga provat materiale të administruara, andaj edhe të njëjtën e ka aprovuar pjesërisht sikurse është cekur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në lidhje me lartësinë e kërkesave të aprovuara sikurse në shumat si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata konstaton se të njëjtat janë adekuate, e gjithë kjo duke u bazuar në lëndimet e pësuar nga paditësi si pasojë e aksidentit të shkaktuar. Duke u bazuar në ekspertizën e ortopedisë - traumatologjisë dhe ekspertizën e psikiatrisë të punuar nga Dr. M.H. dhe Dr. N.I.M. e datës 26.07.2023, gjykata ka vërtetuar faktin se lëndimet e paditësit janë lëndime të rënda trupore. Lëndimet të cilat i ka pësuar paditësi i kishin shkaktuar dhimbje

fizike të të gjitha llojeve: posaçërisht të rëndë, të intensitetit të rëndë, të intensitetit të mesëm dhe të intensitetit të lehtë. Po ashtu paditësit i është zvogëluar aktiviteti i përgjithshëm jetësor në shkallën prej 18.40 %. E gjithashtu paditësi ka pësuar shëmtim trupor në shkallë të mesme-e dukshme për personat e tretë, për shkak të plagës operatore. Si pasojë e lëndimeve të marra në aksident paditësi kishte pasur nevojë për ndihmën e personit të tretë (70 ditë), ushqim të përforcuar dhe rehabilitimi fizioterapeutik. Është vërtetuar po ashtu se paditësi në aksidentin e ndodhur kishte përjetuar të gjitha llojet e frikës: primare, sekondare të intensitetit të lartë, sekondare të intensitetit të mesëm, sekondare të intensitetit ulët, e cila ende manifestohet, e të cilat janë përshkruar ekspertizën e ortopedisë - traumatologjisë dhe ekspertizën e psikiatrisë të punuar nga Dr. M.H. dhe Dr. N.I.M. e datës 26.07.2023. Ekspertizës në fjalë, gjykata ia fali besimin e plotë. Ndërgjyqësit nuk kishin vërejtje në ekspertizën e ortopedisë-traumatologjisë dhe të psikiatrisë, andaj në rastin konkret mes palëve nuk kemi fakte kontestuese sa i përket këtyre ekspertizave dhe lëndimeve të pësuar nga paditësi dhe frikës së përjetuar nga i njëjti. Andaj, të gjitha këto e kanë bindur gjykatën që të vendos sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditësit, pasi që shumat e aprovuara janë në përputhje të plotë me lëndimet e pësuar nga paditësi.

Gjykata vendosi si në dispozitivin nën II të këtij aktgjykimi ngase konsideroi se shumat e kërkuara mbi shumat e aprovuara si në pikën I të dispozitivit janë të larta dhe nuk i përgjigjen lëndimeve të cilat i ka pësuar paditësi në aksidentin e datës 11.10.2020 dhe të gjitha rrethanave tjera të cilat janë me rëndësi për vlerësimin dhe caktimin e kompensimit. Andaj, gjykata vlerëson se me vlerat të cilat ka aprovuar në emër të dëmit jo material do të arrihej qëllimi i kompensimit të drejtë të dëmit të pësuar me aksidentin në komunikacion. Gjithsesi, gjykata mori për bazë kushtet dhe rrethanat në të cilat është shkaktuar ky aksident, moshën e paditësit si dhe gjendjen ekonomike në Kosovë, si dhe Udhëzuesin e Gjykatës Supreme të Kosovës me nr.41/2023, të datës 27.02.2023.

Lidhur me kërkesën e paditësit, që ka të bëjë me detyrimin e palës së paditur që paditësit në emër të personit të tretë të i'a paguaj shumën prej 250.00 euro, në emër të ushqimit të përforcuar shumën prej 490.00 euro, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pika I, pika 2), nën pika e) dhe f), duke i aprovuar kërkesat e të njëjtit pasi që kjo gjykatë i vlerëson si të pranueshme për nga baza, duke marr për bazë kohëzgjatjen e nevojës për përkujdesjen e personit të tretë, ushqimin e përforcuar të konstatuar në ekspertizë mjekësore për paditësin, si dhe nga fakti që praktika gjyqësore i njeh rastet e tilla të kompensimit. Në këtë drejtim, duhet të merret parasysh fakti se për këto forma të dëmit në shumicën dërmuese të rasteve palët e kanë të pamundur apo shumë të vështirë të sigurojnë dëshmi konkrete, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm, është vështirë të argumentohet me prova konkrete. Mirëpo, pasi që paditësi ka pasur nevojë për ndihmën e huaj, ushqim të përforcuar (sikurse në ekspertizë), të njëjtit ligjërisht i takon kompensimi për këtë lloj të dëmit material dhe në shumat e vlerësuara nga ana e gjykatës.

Ndërsa sa i përket dëmit material tjetër i cili rrjedh si pasojë e shërimit të paditësit, pas shkaktimit të aksidentit (blerja e barnave, vizitave mjekësore për shërim),gjykata vendoi si në

pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pika 2), nën pika h) dhe atë në shumën prej 1,274.00 €, pasi janë të argumentuar me prova konkrete (faturave), të cilave gjykata ia fal besimin e plotë.

Ekspertët përkatës e kanë vlerësuar se lëndimet e paditësit janë lëndime të cilat karakterizohen si lëndime të karakterit të rëndë trupor. Andaj, edhe lartësia e shumës së të hollave në emër të kompensimit, do t'i mundësojë të dëmtuarit-paditësit, satisfaksion që ai të jetë në gjendje ti kompensojë të mirat jo materiale dhe materiale nga të cilat është privuar, e kjo duke marr parasysh të gjitha rrethanat e lëndimeve të shkaktuara, intensitetin e dhimbjeve, frikës, kohëzgjatjen e tyre, kohën e nevojshme të shërimit dhe të gjitha lëndimeve tjera të përshkruara më hollësisht në ekspertizën e ekspertëve përkatës, të cilat i kemi përmendur më lartë, gjykata ka vendosur sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata, ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pika I, pika 2), nën pika i), duke e detyruar të paditurën B.K.S. që në emër të fitimit të humbur, nga data 11.10.2020-30.11.2023, ti paguaj paditësit shumën prej 3,090.32 euro, ndërsa prej datës 01.08.2023, në emër të rentës mujore ti paguaj paditësit shumën prej 37.44 €, në muaj dhe atë derisa të ekzistojnë kushtet ligjore, kjo pasi që bazuar në ekspertizën mjekësore nga mjekësia e punës e punuar nga Dr. Xh.Sh. specialist i mjekësisë së punës, paditësi J.H. në aksidentin e datës 11.10.2020, kishte pësuar lëndime trupore të cilat për pasojë kanë vështirësimin dhe zvogëlimin e mundësisë së kryerjes së disa profile punësh. Ku fillimisht nga dita e aksidentit 11.10.2020, në vitin e parë të aksidentit, deri me 10.10.2021, paaftësia e përkohshme për çdo lloj pune ka qenë në shkallë prej 99 %. Për 12 muajt vijues, nga data 11.10.2021 deri me 10.10.2022, paaftësia për punë ka qenë në shkallë prej 50 %, ndërsa nga data 11.10.2022, e më tutje në të ardhmen, Zvogëlimi i aftësisë së përgjithshme të punës është i përhershëm në shkallë prej 24%. Ekspertizës së punës të punuar nga Dr. Xh.Sh. specialist i mjekësisë së punës, gjykata ia fali besimin e plotë, pasi që e njëjta është punuar pas ekzaminimit të drejtpërdrejtë të paditësit, shkresave të lëndës, si dhe konstatimeve të ekspertit të ortopedisë-traumatologjisë dhe ekspertit psikiatër. Ndërsa nga ekspertiza e aktuaristikës dhe plotësimi i ekspertizës i datës 01.03.2024, e punuar nga ekspertja e aktuaristikës G.Sh. është konstatuar se shuma e cila duhet ti paguhet paditësit, në emër të fitimit të humbur nga data e aksidentit 11.10.2020, deri me datën 30.11.2023, arrin vlerën prej 3,090.32 euro, ndërsa renta mujore e cila duhet ti paguhet paditësit pas datës 01.12.2023, për nivelin e paaftësisë punuese të paditësit, arrin totalin mujor në lartësi prej 37.44 euro, e atë deri sa të ekzistojnë kushtet ligjore. Ekspertizës në fjalë gjykata ia fali besimin e plotë, pasi që ekspertja përlllogaritjen e fitimit të humbur e ka bërë bazuar në punën të cilën e ka bërë paditësi para aksidentit dhe të cilën vazhdon ta bënë pas aksidentit, përkatësisht e njëjta ka zbritur të ardhurat e realizuara nga paditësi nga data e aksidentit, e deri në përpilimin e ekspertizës, si dhe rentën mujore pas përpilimit të ekspertizës, në raport me zvogëlimin e aftësisë punuese të paditësit, të konstatuar nga ekspertiza mjekësore e punës.

Duke u bazuar në këtë gjendje faktike gjykata ka vendosur si në dispozitivit të këtij aktgjykimi, për kompensimin e dëmit jo material dhe material të shkaktuar te vet paditësi, si dhe duke u bazuar në nenin 323 të LPK-së, lidhur me në nenin 136 parag.1 të LMD-së, i aplikueshëm i cili përcakton: *"Kush i shkaktonte dëmin ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij "*, lidhur me nenet 159, 169, 174, 179, dhe

183 të LMD-së, dhe nenin 10, nenit 9 par.1 dhe nenit 25, të Ligjit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (Ligji Nr.04/L-018).

Në lidhje me kamatën ligjore që duhet ta paguaj e paditura për shumën e aprovuar për dëmin jo material dhe material, me kamatë prej 8%, krejt kjo duke u bazuar në nenin 382 parag. 1 dhe 2 të LMD-së, si dhe duke u bazuar në mendimin Juridik të Gjykatës Supreme me nr.265/2020, të datës 02.12.2020, pjesa e tretë pika XIV, Gjykata për dëmin material vendosi që kamatë fillon të rrjedhë nga data e parashtrimit të padisë (datë 23.03.2021), ndërsa kamata për dëmin jo material fillon të rrjedhë nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi (datë 20.05.2024) duke u bazuar në mendimin juridik të lartcekur pika XV.

Gjykata i ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të administruara në shqyrtimin kryesor, por erdhi në përfundim se të njëjtat janë pa ndikim në vendosjen meritore të kësaj çështje juridike-kontestimore.

Për pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata vendosi konform nenit 452 parag.1 lidhur me nenin 463.1 të LPK-së, si dhe në bazë të TA-së, në të cilat janë përfshirë, përpilimi i padisë në shumë prej 208.00 €, për taksën gjyqësore shumë prej 100.00 €, për përfaqësim në 4 seanca gjyqësore shumë prej 1,081.60 € (4x270.40), në emër të ekspertizës mjekësore të ortopedisë dhe të psikiatrisë shumë prej 300.00€, në emër të ekspertizës së ekspertit të punës shumë prej 150.00 €, në emër të ekspertizës së ekspertes të aktuaristikës shumë prej 150.00 €, apo shumë e përgjithshme prej 1,989.60 € (njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e nëntë euro, e gjashtëdhjetë cent). Pjesën tjetër të kërkesës së paditësit sa i përket shpenzimeve procedura për përpilimin e parashtrësës për precizimin e lartësisë së kërkesëpadisë në shumë prej 208.00 euro, gjykata e vlerësoi si të pabazuar, pasi që gjykata vlerëson se precizimi i lartësisë së kërkesëpadisë mund të bëhet drejtpërdrejt në seancë dhe si i tillë nuk paraqitet si shpenzim i nevojshëm për ndjekjen e çështjes në gjyq siç përcakton nenin 453. par.1 i LPK-së.

Nga të cekurat më lartë dhe bazuar në nenet 136, 137, 140, 159, 169, 172 par.1 dhe 2, 174, 179 dhe 183 të LMD-së, lidhur me nenin 323 dhe 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**  
**C.nr.473/2021, datë 20.06.2024**

**G j y q t a r i**

**Taulant Rexhëbeqaj**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 dite pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj gjykate.

Numri i lëndës: 2021:054487  
Datë: 20.06.2024  
Numri i dokumentit: 05839853